



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 544/6 Prot.

Tiranë, më 25.11.2016

**V E N D I M**

Nr.148, Datë 25/11/2016

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dispozita të cilat në mbështetje të nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", lejohet të veprojnë, si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", është urdhëruar të fillojë mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe ka përfshirë monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt filloi në datë 07.09.2016 në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 544 prot., datë 02.09.2016, të miratuar nga Komisioneri.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 544/2 prot., datë 31.10.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Projektraporti i mbikëqyrjes, i është dërguar për njohje, me shkresën nr. 544/3 prot., datë 31.10.2016, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, dhe, me shkresën nr. 544/4 prot., datë 31.10.2016, Departamentit të Administratës Publike.

Në vijim të këtij procesi, me shkresën nr. 284/3 prot., datë 11.11.2016, institucioni ka dërguar të nënshkruar pa vërejtje projektraportin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, si dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamentin e Administratës Publike, në momentin e rishikimit të strukturës, duhet të parashikojnë në këtë strukturë, një pozicion pune për t'u kujdesur për veprimtarinë e përditshme të burimeve njerëzore të institucionit.
3. Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të vijojë procesin si më poshtë:
  - Të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës në momentin e dokumentimit të tyre, duke depozituar një kopje pranë Departamentit të Administratës Publike.
  - Të administrojë në dosjet individuale të punonjësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , aktet që

vërtetojnë plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës “*Master Profesional*”, sipas orientimeve në Raportin Përfundimtar të mbikëqyrjes.

- Të nënshkruhen formularët e përshkrimit të punës në rastet e nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , dhe më pas, kjo kopje e aktit të vendoset në dosjen individuale të personelit.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
  5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
  6. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
  7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**